Asnjëherë mos blini ose shisni produkte në kanale të tjera elektronike apo njësi të shitjes me pakicë. Duke marrë parasysh mundësitë e ndryshme të shitjes nëpërmjet medias elektronike, sipas Forever Living Products: këto konsiderohen si njësi të shitjes me pakicë. Sipas politikës aktuale të biznesit qarkullimi i produkteve ose publikimi i formularëve të FLP-s në njësitë e shitjes me pakicë është rreptësisht i ndaluar. Qarkullimi i produkteve me anë të medias elektronike mund të bëhet vetëm nëpërmjet faqes së internetit www.flpseeu.com!

INFORMACIONE ME VLERË

Kompania jonë u ofron Distributorëve të saj mundësi të ndryshme të për të kontrolluar pikët e tyre:

– Në internet. Informacionin rreth kësaj e gjeni në pjesën e Njoftimeve me titull INTERNET.

– Informacione rreth pikëve mund të kërkonit edhe nëpërmjet **sistemit-SMS** që funksionon me sukses prej vitesh.

– Edhe punonjësit e **shërbimit telefonik** të zyrës sonë qendrore të Budapestit ju informojnë me kënaqësi rreth të dhënave aktuale të qarkullimit tuaj. Vlerat e pikëve personale distributorët e Budapestit mund t'i pyesin në numrin e telefonit +36-1-269-53-70 dhe +36-1-269-53-71, kurse të Kroacisë, Bosnia-Hercegovinës, Sllovenisë, Serbisë dhe Malit të Zi +36-1-322-55-41.

Ju lutemi të interesoheni vetëm për pikët dhe biznesin tuaj personal!

I lutemi Shpërndarësve tanë të nderuar që edhe në të ardhmen t'i kushtojnë kujdes plotësisht të saktë të formularëve, sidomos të fletës së regjistrimit të distributorit, e cila është kontrata ndërmjet distributorit dhe FLP-s! Formularët e korigjuar dhe dhe të panënshkruar të regjistrimit dhe porosisë së produkteve nuk mund t'i pranojmë për shkak të shmangjes së gabimeve!

Pranojmë vetëm kontratat me nën shkrim personal! Çdo nënshkrim tjetër konsiderohet si fallçifikim doku mentash!

Në rastin e ndryshimit të adresës apo të emrit s'është e mjaftueshme ta shkruani atë në fletën e porosisë së produkteve. Për këtë ju lutemi të përdorni formularin e ndryshimit të të dhënave!

Në interes të sigurisë së çështjeve financiare ju lutemi, që në rastin e kontrollit të pikëve nëpërmjet autorizimit, personi i autorizuar të sjell me vete letërnjoftimin e tij!

Sipas Politikës Ndërkombëtare të Biznesit, çdo distributor që nënshkruan formularin e regjistrimit (kontratën), fiton të drejtën e blerjes së produkteve me çmim shumice direkt nga zyrat. Ndërkohë distributor i regjistruar ai bëhet vetëm gjatë blerjes së parë, duke paraqitur 2 kopje të formularit të regjistrimit të vulosur dhe dorëzuar më parë.



Programi në internet nga 25 janar deri në 22 janar 2010

- | | |
|------------------------|---|
| 18:00 dhe 06:00 | Himni |
| 18:05 dhe 06:05 | Dr. Maria Hoci Mbrojtja e organizmit tonë në muajt e dimrit |
| 18:25 dhe 06:25 | Dr. Ida Nagy dhe Dr. Ferenc Kiss Mbrojtja e shëndetit në pranverë |
| 18:50 dhe 06:50 | Attila Pataki, Edda |
| 19:05 dhe 07:05 | Ëndrra jote është plani ynë Hyrje në FLP |
| 19:10 dhe 07:10 | Supervizorë, Asistent m... Pjesa 1 |
| 19:45 dhe 07:45 | Supervizorë, Asistent m... Pjesa 2 |
| 20:15 dhe 08:15 | Menaxherë, Menaxherë drejtues |
| 22:15 dhe 10:15 | Ëndrra jote është plani ynë Produktet FLP |
| 22:20 dhe 10:20 | Konkurs makijazhi Sonya |
| 23:00 dhe 11:00 | Bence Nogradi Të mbijetosh |
| 23:25 dhe 11:25 | Ëndrra jote është plani ynë Mundësia FLP |
| 23:30 dhe 11:30 | Supervizorë, Asistent m... |
| 23:55 dhe 11:55 | Emil Tonk Biznesi është vlerë- Si t'i përfaqësojmë vlerat |
| 00:35 dhe 12:35 | Menaxherë, Menaxherë drejtues |
| 02:00 dhe 14:00 | Klub sportiv i kërcimit me litar |
| 02:10 dhe 14:10 | Mariann Szeker Mundësi të reja në FLP |
| 02:30 dhe 14:30 | Supervizorë, Asistent m... |
| 02:45 dhe 14:45 | Menaxherë, Menaxherë drejtues, Sundimtarë |
| 03:30 dhe 15:30 | Koncert |
| 04:05 dhe 16:05 | Dariusz Heinbach Zgjedhje fushe |
| 04:25 dhe 16:25 | Dr. Terezia Samu Guxo të ëndërros |
| 05:10 dhe 17:10 | Miklos Berkics Çelësi |
| 05:35 dhe 17:35 | Olly dhe Gabi Berkes |

www.flpseeu.com



NJOFTIMET E PËRFAQËSIVE TË HUNGARISË

TË REJA

Që nga dita e sotme Telecenter zotëron numër të ri TË GJELBËR: 06-80-204-983. Ky shërbim funksionon gjatë ditëve të punës në orarin 12-16 dhe mund të telefonohet falas. Natyrisht Telecenter mund të arrihet akoma edhe në numrat e vjetër: +36-1-297-5538, +36-20-456-8141, +36-20-456-8149

KALENDARI I AKTIVITETEVE

BEOGRAD — Success Day: 2010. 01. 23.
BUDAPEST — Success Day: 2010. 02. 20.; Success Day: 2010. 03. 13.; Success Day: 2010. 05. 22.; Success Day: 2010. 07. 24.; Success Day: 2010. 09. 11.; Success Day: 2010. 10. 16.; Success Day: 2010. 11. 20.; Success Day: 2010. 12. 18.

POROSI PRODUKTESH

Blerësit që i sigurojnë produktet jo personalisht, por me autorizim mund t'i bëjnë porositë e tyre në mënyrën e mëposhtme:

– në telefon, ku punonjësi ynë ju jep informacione të sakta rreth shumës së porosisë, vlerës së saj në pikë dhe çmimit të transportit: +36-1-297-5538, +36-1-297-5539, cel: +36-20-456-8141, +36-20-456-8149 numri i gjelbër: +36-80-204-983 (mund të telefonohet falas gjatë ditëve të punës në orarin 12-16)

– me sms në numrin e telefonit +36-20-478-4732.

– në internet: në faqen www.flpseeu.com! Zgjidhja më e thjeshtë dhe më e sigurt – jo vetëm përsa i përket blerjes së drejtpërdrejtë të produkteve, por edhe regjistrimit të porosisë. Është një mjet i shkëlqyer edhe gjatë rekomandimit të produkteve, pasi kjo ofertë është joshëse për çdo të interesuar. Vlera e pikëve të çdo porosisë brenda 24 orëve i shtohet vlerës aktuale. Dyqani ynë web mund të arrihet drejtpërdrejtë në adresën www.flpshop.hu, kurse vlera e pikëve dhe mund të ndiqet me vëmendje në faqen internetit www.foreverliving.com.

BLERJE ME ULJE

Partnerët tanë me shtetësi hungareze pjesën e shpërblimit që u takon për blerjet personale mund ta marrin në formën e uljes së çmimit.

Sipas kërkesës suaj uljen e zbresim nga shumta e çeqeve të blerjes, kështu që Ju paguani më pak. Procesi i blerjes me ulje është si mëposhtë:

1. Deklarata. Nëse Ju dëshironi ta shfrytëzoni këtë mundësi duhet ta deklaroni këtë duke plotësuar formularin përkatës.

2. Blerja: Sistemi e zbrit automatikisht uljen në çmim nga shumta gjithsej. Por kjo shumë për çdo person nuk mund të kalojë 35% të shumës gjithsej neto. Nëse ulja e mbledhur në emrin Tuaj është më e madhe se kjo shumë, atëherë shumën e mbetur ua llogarisim gjatë blerjes së ardhshme, përsëri deri në vlerën 35% të shumës gjithsej të re, pastaj ky proces përsëritet mëtej.

Në rastin e blerjes me ulje nevojitet vërtetimi i identitetit Tuaj ose i personit të autorizuarit me letërnjoftim me fotografi.

3. Informimi: Shumës që mund të merret në përdorim në datën 15 të çdo muaji i shtojmë uljet e reja që rrjedhin nga blerjet e muajit të kaluar. Rreth shumës aktuale të uljes kolegët tanë mund t'ju japin informacione juve ose personit të autorizuar vetëm personalisht, pas paraqitjes së letërnjoftimit me fotografi. Për detaje të mëtejshme interesohuni tel sponsorët ose punonjësit tanë.

TRANSPORTI

Dëshiroj t'u thërras vëmendjen distributorëve të Hungarisë për shërbimin tonë të transportimit të pakove. Me anë të këtij shërbimi Ju i marrim porositë e bëra maksimum brenda 2 ditëve – në kohë të përcaktuar – në çdo zonë të vendit, të cilat duhen marrë brenda 48 orëve, pasi në rast të kundërt ato i anullojmë dhe pikët i zbresim. Çmimi i produkteve të porositura dhe ai i transportit duhet paguar kur pakoja merret në dorë. Në rastin e blerjes me vlerë mbi 1 pikë shpenzimet e transportit paguhen nga kompania.

INFORMACIONE ME VLERË

I lutemi Distributorëve të Nderuar, që bashkë me formularin e tyre të regjistrimit të dorëzojnë edhe kopjen e lishencës së tyre të tregëtisë! Në të ardhmen vetëm me këtë dokument mund t'u japim shpërblime! Ata partnerë të Hungarisë, të cilët për blerjet e bëra dëshirojnë të nxjerrin llogari në emrin e firmës së tyre personale, mund ta bëjnë këtë vetëm në

rast se dërgojnë formularët e nevojshëm të plotësuar, dhe një kopje të dokumentit që vërteton pozitën e tij si pronar i firmës. Njoftimi i hollësishëm në lidhje me këtë gjendet në zyrat tona, por me kërkesën tuaj mund t'ju njoftojnë edhe gojarisht.

Numrat telefonik të specialistëve tanë mjek:

Dr. Kassai Gabriella 20/234-2925
Dr. Kozma Brigitta 20/261-3626
Dr. Mezösi László 20/251-9989
Dr. Németh Endre 30/218-9004
Siklósné dr. Révész Edit 20/255-2122
Numri telefonik i specialistit tonë mjek të pavarur:
Dr. Bakanek György 20/365-5959

Produktet e Forever Living Products i nxjerrim në treg me rekomandimin e Shoqatës së Mjekësisë Popullore të Hungarisë.

PËRFAQËSITË TONA

Forever Living Products

• Qendra Mësimore:
1067 Budapest, Szondi utca 34.
tel.: +36-1-332-5956, +36-20-253-3614
Menaxher projekti: Dr. Gothárd Csaba
• Drejtoria e Tregëtisë e Budapestit:
1183 Budapest, Nefelejcs u. 9–11.
tel.: +36-1-291-8995, +36-20-465-6280
Drejtori i rajonit: Földi Attila
• Drejtoria Rajonale e Debrecenit:
4025 Debrecen, Erzsébet u. 48.
tel.: +36-52-349-657, +36-20-914-2945
Drejtori i rajonit: Pósa Kálmán.
• Drejtoria Rajonale e Szegedit:
6721 Szeged, Tisza Lajos krt. 25.
tel.: +36-62-425-505, +36-20-251-1712
Drejtori i rajonit: Radóczki Tibor
• Drejtoria Rajonale e Szekesfehervarit:
8000 Szekesfehervár, Sóstói út 3.
tel.: +36-22-333-167, +36-20-467-8603
Drejtori i rajonit: Kiss Tibor

Forever Resorts

• Hoteli Kështjella e Szirakit
3044 Szirák, Petőfi u. 26.
tel: +36-32-485-300,
fax: +36-32-485-285.
Drejtoresha e hotelit: Király Katalin
Faqja e internetit: www.kastelyszirak.info



NORBERT VARGA PARAQITET NGA NEW YORK-U

LETËR DREJTORIT GJENERAL DR. SANDOR MILESZ

BUSINESS REPLY MAIL
FIRST-CLASS MAIL PERMIT NO. 3611 NEW YORK, NY

I dashur Sandor!

Kërkojë ndjesë nëse të shqetësoj me letrën time në vrullin e fundit të vitit. Qëllimi i kësaj letre s'është tjetër veçse shprehja e falenderimeve të mia dhe rrethit të distributorëve amerikano-hungarez të FLP-s për shpirtmirësinë tënde që ndihmon-ndihmoni edhe kolegët e zellsbëm dhe të angazhuar jashtështetit që flasin hungarisht!

Ndoshta nuk e mendoni se çfarë kënaqësie, ndihme dhe nderi përbëjnë për ne këto revista mujore në gjuhën hungareze.

Kryesisht për faktin se na vjen mirë që mendoni për ne dhe gëzojmë mbështetjen Tuaj kudo që jemi në botë!

Flasim një gjuhë, mendojmë njëloj dhe zemra jonë do të rrahë gjithmonë si hungarez!

Ne s'mund të na ndaj asnjëri prej JUSH, ne do të mbetemi gjithmonë "hungarez"!

Këtu jashtë na thonë shpeshherë që: "Këtu nuk jemi në Hungari, por në USA, këtu nuk funksionon gjithçka si në shtëpinë tuaj!" Por çfarëdo të ndodh, unë do ta vendos gjithmonë pranë emrit tim "qëndrimin dhe forcën imagjinuëse" të anëtarëve hungarez të FLP-s, nëse kjo ka funksionuar dhe funksionon në atë vend të vogël, atëherë duhet të funksionoj edhe këtu dhe kudo në botë!

Nuk diskutohet – po të shohim statistikën dhe numrin e popullsisë – që Hungaria kryeson në aspektin e shitjeve të FLP-s!

(Brazil: 280 milion banorë: 80000 cc në muaj

Japonia: 120 milion banorë: 52000 cc në muaj

Hungaria – të shohim gjithë shtetet anëtare – 33 milion banorë: 25-30000 cc në muaj!!!)

Ajo që Ju krijuat në atë vend të vogël për ne është pavarësia!

Pa ato që marrim prej Jush – kaseta, CD, aktivitete, FLP-Tv – edhe ne nuk do të ishim aty ku jemi!

Në sytë tanë Ju jeni arteria kryesore pa të cilën nuk do ekzistonim dot.

Sistemi që krijuat është sistemi që funksionon më mirë mes 143 shtetesh.

Nga kjo rrugë nuk duhet të dalim, por duhet të përparojmë po kështu, në mënyrë të kualifikuar edhe në të ardhmen.

Çfarë mund t'ju uroj në pjesën e mbetur të vitit, atë që ju urojmë gjithmonë, mos i shtyni gjërat. Punën E SOTME mose e lini për nesër. S'ka gjë më të rëndësishme në biznesin tonë se sa të kryesh detyrat e asaj dite, gjë e cila përbën zhvillimin tënd personal dhe biznesit, apo jo?!

Më në fund falenderojmë gjithë punonjësit e Hungarisë dhe shteteve anëtare për gjithë punën e kryer në FOREVER, pasi e dimë se pa punën e tyre nuk do të funksionon gjërat që ju ngritën në majën më të lartë.

Suksese të shumta FLP Hungari!

Me respekt: në emër të distributorëve amerikano-hungarez të FLP-s:

Norbert Varga, një distributor "I PËRKUSHTUAR"

PAR AVION
AIR MAIL
CORREO AEREO



NJOFTIMET E ZYRAVE



SERBIA

Zyra e Beogradit: 11000 Beograd, Kumodraska 162, tel.: +381-11-3970-127. Orari i hapjes: të hënën, të martën dhe të enjten 12.00-19.30, të mërkurën dhe të premten 9.00-16.30.

Zyra e Nisit: 18000 Niš, Učitelj Tasina 13/1., tel.: +381-18-514-130, +381-18-514-131.

Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 11.00-19.00, në ditët e tjera të punës 9.00-17.00.

Zyra e Horgosit: 24410 Horgoš, Bartok Béla 80. tel.: +381-24-792-195. Orari i hapjes në ditët e punës: 8.00 - 16.00. Drejtori i rajonit: Branislav Rajic.

Drejtori i rajonit: Branislav Rajic.

Forever Living Products Beograd na ofron shërbimet e mëposhtme:

bërje porosish në telefon - Telecenter. Numri i telefonit: 011/309-6382. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12: 00-19.30, të mërkurën dhe të premten 9:00-16.30. Në rastin e porositjes në telefon malli shkon tek adresa që gjendet në numrin e kodit dhe paguhet kur merret në dorë.

– Pagesa e produkteve bëhet pasi ato merren në dorë.

Vlera e transportit është 600 dinar dhe paguhet nga porositësi.

– Shpenzimet e postës duhen paguar në bazë të kursit të parasë në Serbi në ditën që ndodh marrja e mallit, dhe ato merren përsipër nga FLP-ja e Beogradit vetëm në rastin kur vlera e porositës së bërë është më e madhe se 1 pikë.

– Nuk mund të bëhet regjistrim nëpërmjet telefonit.

– Porositë telefonike merren në shqyrtim deri në datën 25 të muajit, pas kësaj date mund të porosisni vetëm personalisht në zyrën tonë.

– Edhe në zyrën e Horgosit dhe Nisit mund të blihen materiale reklamash, fletat e regjistrimit dhe formularët për ndryshimin e të dhënave.

Numrat i telefonit të specialistëve mjek:

Dr. Biserka Lazarević dhe dr. Predrag Lazarević: +381-23-543-318

Të martën në orën 13.00-16.00 dhe të premten në orën 14.00-16.00 presin thirrjet tuaja për konsultim.

Dr. Božidar Kaurinović:

+381-21-636-9575

Të mërkurën dhe të enjten në orën 12-14 pret ethirrjet tuaja për konsultim.



MALI I ZI

81 000 Podgorica, Serdara Jola Piletića 20.

tel. +382-20-245-412, tel./fax: +382-20-245-402.

Orari i punës: të hënën: 12:00 – 20:00. Në ditët e tjera të punës: 9:00 – 17:00. E shtuna e fundit e çdo muaji është ditë pune. Orari i punës: 9:00 – 14:00.

Drejtori i rajonit: Aleksandar Dakić

– Porosi produktesh mund të bëni në numrat telefonik të mëposhtëm: +382-20-245-412; +382-20-245-402.

Pagesa bëhet kur merret malli. Nëse vlera e produktit të porositur e kalon 1 pikë, shpenzimet e transportit i merr përsipër FLP-ja.

Numri i telefonit i specialistes mjek:

Dr. Laban Nevenka: +382-69-327-127



SLLOVENIA

1236 Trzin-Ljubljana, Borovec 3., tel.: +386-1-562-3640.

Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00, të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00.

Adresa e magazinës së Lendavit: 9220 Lendava, Kolodvorska 14., tel.: +386-2-575-12-70, Fax: +386-2-575-12-71, e-mail: forever.living@siol.net. Orari i hapjes: të hënën 12.00-20.00, të martën dhe të premten 09.00-17.00.

Drejtori i rajonit: Kepe Andrej

Numri i Telecenterit në rastin e porosive telefonike është: +386-1-563-7501. Në rastin e porosive telefonike, mallin e dërgojmë në adresën që i përket kodit. Distributorët që duan të porosisin mall në emër të një distributori tjetër, duhet të kenë autorizim nga distributori në emrin e të cilit duan të bëjnë porosinë. Formularët e autorizimit mund të sigurohen në zyrë. Malli i porositur në telefon transportohet për dy ditë pune!

Numrat i telefonit të specialistëve mjek:

Dr. Arbeiter Miran: +386-4142-0788

Dr. Olga Čanzek: +386-4182-4163



JUGLINDORE



KROACIA

Zyra e Zagrebit: 10000 Zagreb, Trakošćanska 16., tel: 01/3909 770; fax: 01/3704 814. Njoftojmë punonjësit dhe konsumatorët tanë se zgjatëm orarin e hapjes së zyrës së FLP-s së Zagrebit: të hënën dhe të enjten: 09:00 - 20:00; të martën, të mërkurën dhe të premten 09:00 - 17:00.

Drejtori i rajonit: Dr. Molnár László

– Porosia telefonike: +385-1-3909-773. Në rastin e porosive me vlerë më të madhe se 1 pikë krediti, çmimi i transportit paguhet nga FLP-ja.

– Leksionet në lidhje me produktet dhe marketingun mbahet të hënën, të martën dhe të mërkurën nga ora 17 në zyrën qendrore.

– Qendra e kozmetikës që funksionon në ndërtesën e zyrës qendrore u ofron anëtarëve të FLP-s shërbime me çmime të favorshme.

– Orari i hapjes së qendrës është: të hënën dhe të mërkurën 09:00 – 12:00, të martën dhe të enjten 15:00 – 20:00, kurse të premten 14:00 – 17:00. Paraqitja bëhet në numrin e telefonit 01/3909 773.

NJOFTIM I RËNDËSISHËM: Nga data 1 mars 2008 nëse vlera e produkteve të blera ose të shërbimeve të sallorit kozmetik të marra në përdorim është më e madhe se 1500 kuna, me kartë DC kjo shumë mund të paguhet në 2-3 pjesë. Shfrytëzoheni mundësinë e blerjes me ulje! Për detajet interesohuni tek sponsori juaj ose tek punonjësit e zyrës.

Numri i telefonit i specialistes mjeke:

Dr. Davorka Vitlov Čirjak: +385-9151-07070
(në ditët çifte në orarin 08:00-10:00)



SHQIPËRIA

Shqipëri, Tiranë, Reshit Collaku 36. tel/fax: +355 42230 535.

Drejtori rajonal: Attila Borbáth

Drejtori i zyrës: Xhelo Kiçaj, tel/fax: +355-694066 811.
Kontaktim: në ditët e punës 9-13, 16-20,
e-mail: flpalbania@abcom.al



SARAJEVA

– Nga shtatori kemi në dispozicion këshilltaren-specialisten mjeke të Bosnia-Hercegovinës në numrin e telefonit: **Dr. Nišić Ema** +387-62-367-545, e cila gjatë ditëve të punës punon në orarin 18:00 – 21:00.

– Këshilltarja-specialistja jonë mjeke çdo të mërkurë mban konsultime në zyrën e Sarajevës në orarin 17:00 – 19:30.

– Në rastin e porosisë telefonike pagesa bëhet kur merret malli. Nëse vlera e porosisë nuk është më e madhe se 1 pikë krediti, atëherë shpenzimet e transportit paguhet nga distributori.



BOSNIA-HERCEGOVINA

Zyra e Bijelinës: 76300 Bijeljina, Trg D. Mihajlovića 3., tel: +387-55-211-784, +387-55-212-605, fax: +387-55-221-780.

Orari i hapjes në ditët e punës: 9.00-17.00.

Drejtori i rajonit: Dr. Slavko Paleksić

Zyra e Sarajevës: 71000 Sarajevo, Akita Šeremeta do br. 10., tel.: +387-33-760-650, +387-33-470-682, fax: +387-33-760-651. Orari i hapjes: të hënën, të enjten, të premten: 09.00-16.30, të martën, të mërkurën: 12.00-20.00.

Në çdo të shtunë të fundit të muajit organizojmë një Ditë Suksesi Mini në zyrën e FLP-s.

Drejtori i zyrës: Enra Hadžović

– Në zyrat e Bosnias porositë telefonike mund të bëhen në numrat e mëposhtëm (regjistrimi i shpërndarësve të rinj nuk mund të bëhet nëpërmjet telefonit): +387-55-211-784, Bijelinë dhe +387-33-760-650 Sarajevë.



KOSOVA

Pristinë Rr. Uçk br. 94, tel.: +381-38-240-781, +377-44-503-911.



TAKIMI I VISEGRADIT

Fulturim shqiponje i Miki Berkics-it



Të tillë s'kishim parë ndonjëherë! Në një takim Drejtor Gjeneral, Safir Menaxher, një Diamant-Safir me 10000 pikë krediti, një Safir me 10000 pikë krediti, tre Diamant-Safir me 7500 pikë krediti, Soaring, Seniorë... 50.000 pikë krediti, shumë gurë të çmuar, skuadra e më të mirëve! Këta janë: Dr. Sandor Milesz, Dietmar & Christel Reichle, Horst & Margrita Kelm, Jozsef Szabo, Miki Berkics, Attila dhe Katika Gidofalvi, Csaba Toth, Zsofia Czele - Gergely, Tünde Hajcsik, si dhe Menaxherë me mbi 70 pikë, plotësues të mbi 120 pikësh non-menaxheri... Në krahasim me këtë takim i të Katërve i Vesegradit ishte vetëm një festë e zakonshme!



Mendova se Miki mund të nxinte barkun në ishujt Bahama, ka edhe para, edhe kohë për të, por prapë më mirë na organizon një training me përmasa të tilla! Meriton gjithë respektin tim! Po mendoja edhe se ku ndryshon Miki nga ne? Gjeta dy ndryshime bazë, dituria dhe qëndrimi i tij. Këtu i morrëm të dyja, diturinë nga lektorët, kurse qëndrimin e duhur nga atituda e drejtuesve tanë. Dhe kjo është ajo që por ta shikosh më pas në DVD, nuk e përjeton dot, dhe ndoshta pikërisht nga kjo mund të varet ndryshimi për mirë i fatit tënd. Gjithë këtë eksperiencë e morrëm në hotelin ndoshta me nivel më të lartë të vendit tonë të vogël, Hoteli Thermal i Visegradit. Lakitelek është i njohur sepse prej aty kanë dalë shqiponjat e FLP-s që kanë fluturuar më lart, por tani arritëm ta kalojmë edhe këtë: në këto dy ditë ndodhi diçka jo e zakonshme! Ndoshta ishte efekti i Pilisit? Dobogoko, çakra e tokës? Kush e di... ai që ndodhëj aty e ndjeu.

NXEHE

Gjashtëqind njerëz pritën fillimin e të shtunës, të cilën shtriga e biletave, strehimit dhe ushqimit, July Torcom e organizoi me rezultat 150 përqind. Për këtë vetëm ajo është e aftë. Faleminderit July! Dita u hap nga Miki me prezantimin e dy autorëve të shkëlqyer të cilët me librat e tyre ndihmojnë punën tonë. Pastaj erdhën tre njerëz me të vërtetë të rëndësishëm, dhe në mënyrë interesante edhe leksionet e tyre për këtë bënin fjalë: si të bëhemi edhe ne NJERËZ TË RËNDËSISHËM! Zsofia Czele-Gergely me stilin e saj karakteristik dhe mjeshtri precize bëri të njohur hapat më të rëndësishëm dhe përgjigjen e pyetjes: si mund të bëhesh pikërisht ti njeriu i duhur? Ajo u ndoq nga Csaba Toth i cili njohuritë e tij i paketoj duke i kombinuar me humor, çdo fjalë e tij është flori, me fjalë të tjera pikë kartoni! Rrezatonte në skenë, por për të nuk mund të flas dot pa subjektivitet, pasi është miku dhe shembulli im gjithashtu. Edhe Tünde Hajcsik i përcolli njohuritë e saj me qartësinë dhe

dinamizmin e saj të zakonshëm. Dita u mbyll me konsultim në grup në pishinën termale, darkë në tryezë suedeze dhe një mbrëmje argëtuese fantastike.

NJË JETË MË E MIRË

Të djela ishte më intensive: erdhi takimi i të katërve i Visegradit! Szabo – Milesz – Reichle – Kelm.

Drejtuesit e programit – siç e keni parë në Lakitelek – e hapën ditën të veshur me kostume simbolike duke patur shumë efekt në radhët e shikuesve. U shfaq Çezari dhe Kleopatra të cilët përshëndetën të pranishmit me shprehjen „Ave”, pastaj pamë sferën e virgjërshave Vesta: çfarë sjell e ardhmja...

Joska Szabo foli rreth ndryshimit. Mudança! Rreth tij më kujtohet gjithmonë e njëjta gjë: kur dikush nuk vjen nga Bekasmeqyer në qendrën e rrugës Nefelejcs duke thënë se „o, është shumë larg”, po për Joskën nuk ishte larg kur bëri shtatëmbëdhjetë herë 2000 km me makinë që të na sjellë xhelin, të ardhmen? Edhe për ty është larg ndryshimi, edhe për ty „është shumë larg” një jetë më e mirë? E morrëm vesh se çfarë ndodhi në të kaluarën, ku ndodhet tani, por çfarë do të ndodhë në të ardhmen? Këtë nuk na e thanë virgjërshat, por drejtori gjeneral, Sir Alexander Milesz!

Sandor na tregoi një të ardhme nga e cila rreshtat filluan të gumëzhijnë si bletët. Qendra e FLP-s e të ardhmes, qendra jonë e re e konferencave, resorti i rikrijimit... S'është rastësi që na ka çuar në vendin e tretë në botë, pasi vetëm ai guxoi të ëndërojë diçka kaq të madhe! Lavdëroi punën e Mikit, na tregoi vlerat e tij, na bëri të mendohemi që a e dimë me të vërtetë se çfarë marrim prej tij, nëpërmjet tij? E mbështesim atë, i tregojmë ndryshimet, rezultatet, punën e tij?

DËSHTIM DHE NGRITJE

Paso i guri i çmuar i Rolf Kipp, leksioni i Horst dhe Margarita Kelm. „Për atë ishte e lehtë”, tre rrjete dështuan nën të, por nuk u dorëzua, pati besim që ky është biznesi më i madh. E kuptoi MLM-n! Mendim brilant, përse heqin dorë nga ndërtimi i rrjetit shumë njerëz kur i zotërojnë njohuritë e

duhura për suksesin. Ndezi një diagram dritash në kokën e shumë Menaxherëve drejtues, dhe ja ku është shkaku!

Diamant-safir menaxheri Dietmar Reichle vuri pikën mbi i. Rolf Kipp i mbatji 1/1-shin e parë, i tregoi çekun mujor dhe iu vulos fati. Kështu u bë distributori i dytë më i suksesshëm i Europës, natyrisht edhe për të ishte e lehtë, edhe ai kishte lënë prapa tre biznese MLM të dështuara. Prej tij mësuam marifetin e shekullit për ata që u mbaron lista e emrave ose nuk guxojnë të ftojnë njerëz të rinj. Ne e përdorim? Po ti?

Vlerësime, dhurata, 6 pikësh, 70 pikësh, Miki na e shpërblen përsëri me bujari punën tonë. 380 pikët e non-menaxherit të Gidos e shokuan publikun, i tillë vetëm një është në botë!

Në fund pata një ndienjë sikur po ëndërroja (ndoshta disa njerëz e dinë që unë kam bërë gara me makinë), sot me ne ishte Carlos Sainz, Colin Mcrae, Walter Röhrl, Schumacher, dhe na mësonin me çiltërsi. Ndoshta këto dy ditë në një vend ishin specialistët më të mirë të botës, ata që ishin të pranishëm e ndjenë qëndrimin dhe diturinë e këtyre njerëzve të shkëlqyer. Ishte një nder i madh për ne që Miki, rrjetndërtuesi numër një i botës, nga i cili mësojnë njëqind e dyzetë shtete, na kërkoi mua me Agin të drejtojmë këto dy ditë. U përpoqëm të veprojmë në mënyrë të denjë, të jemi drejtuesit e duhur të këtij aktiviteti të veçantë me nivel të lartë! Të falenderojmë shumë Miki!

Dy ditë, por çfarë ditësh! Ditë dhe takim fillimi dhe krijuesi fati.

M'u kujtuan fjalët e babait tim: „Biri im, ai që mëson është injorant, kurse ai që nuk mëson mbetet injorant!” Rolf Kipp e shprehu pak më bukur këtë: „aktiviteti është motori i ndërtimit të rrjetit. Ndize! Shtype deri në fund gazin!”

Ave!

**Agi Geringer
dhe ifj. Gabor Lukacs
Menxherë**



TAKIMI I *kampionëve* TË BOTËS

Katrin Bajri, diamant menaxherja e dyfishtë më e shpejta në botë mban lidhje të ngushta me linjat vëllazërore hungareze: e përforcojnë me vizita reciproke miqësinë në Forever.

Katrin Bajri në „Fluturimin e Shqiponjave” të Hohenrodait ftoi për të mbajtur leksion diamant-safir menaxherët, kampionen e hedhjes së shtizës, **Aranka Vagasi**-n, dhe burrin e saj, babain e tre fëmijëve të tyre, **Andras Kovacs**-in. Çifti e pranoi me kënaqësi ftesën respektuese dhe si përfaqësues të „marketingut familjar” në nivel kombëtar dhe botëror, morrën me vete edhe djalin e tyre **Botond** (Boti), i cili është gjithashtu menaxher. Leksionet e tyre u dëgjuan me ndjenja të thella nga skuadra e madhe e menaxherëve të profit sharing të mbledhur nga Katrin të cilët morrën pjesë në seminarin dy ditor.

ASAT SË BASHKU

Aranka dhe Andras treguan historinë e tyre – nga fillimi i vështirë, vitet e kaluara si sportiste dhe mësues, deri tek suksesi në Forever. Nga parafabrikati ëndërr deri tek shtëpia private. Siç e thotë edhe Katrin: „Tek unë mikrofonin e merr vetëm ai që e ka treguar vetveten!”

Botond mbajti leksion në të dyja ditët dhe kjo e mbushi atë me krenari. Aranka ishte garancia që ai do të shfaqet mirë. Rroku MLM i djalit e

vuri në lëvizje shoqërinë, madje vuri në përdorim edhe muskujt e barkut. Kurse personaliteti i tij simpatik preku zemrat e dëgjuesve femra. „U buzëqesh të gjithëve, dhe ata që më buzëqeshin prapa i regjistroj” – tha, dhe s’ ishte çudi që në pushime u rrethua nga shumë njerëz. „Kur luaj poker i ndaj të gjitha letrat, sepse vetëm kështu mund të gjej asat. Ndonjëherë letra e fundit është asi i katërt!” – tha ai. Leksioni i përzemërt i Arankës dhe Andrasit ishte pika qetësuese e takimit dy ditor. Thelbi i suksesit të Arankës – siç u morr vesh nga leksioni i saj kompakt dhe i qëllimshëm – është: pjesëmarrja me çdo kusht në sfida, me pyetjen „A di të shkruash?”, me generata të shumta në front, duke notuar me hedhje krahash MLM-je. „Për brenda e jo për jashtë!” – thotë në mënyrë të djallëzuar. Prej saj u bë e qartë se këmbëngulja dhe bashkëpunimi që bashkon familjet sjell rezultat: gjatë dhjetë muajve plotësuan kriteret bazë të nivelit I të profit sharing, nivel të cilin e plotësojnë gjithmonë që nga viti 2002, kurse nivelin II që nga viti 2005. Nga skuadra jonë e madhe profit sharing në vitin 2009 në Malaga e plotësuan tridhjetë menaxherë.

FLUTURIM

Pjesëmarrësit e seminarit morrën vesh edhe që nga afërsisht njëmijë menaxherët që gjenden në rrjetin e saj, njëzetë krijojnë frontin, kështu që e kuptuan se si mund të bëhej Aranka një nga katër diamant-safir menaxherët e rajonit hungarez me diamant-safir menaxherin **Robert Varga**, dhjetë safir menaxherë dhe diamant menaxherët e vetëm të rajonit, **Veronika** dhe **Stevan Lomjanski** nga Serbia, në rrjetin e saj.





„Bëj me vullnet atë që kam bërë deri tani” – thotë Aranka – „kryej punën bazë të distributorit. Ndhimoj familjet që punojnë për qëllime të përbashkëta me ne në aspektin e mësimin, zhvillimit, shëndetit, kohës së lirë dhe pavarësisë materiale. Bëj atë që u them të tjerëve. Jap shembull. Parimi im bazë është arritja e katër pikëve aktive deri në datën 9 të çdo muaji. Bëj garë me kompjuterin!” – tregon duke qeshur.

Po kështu punon edhe skuadra jonë më dinamike e frontit me drejtimin e soaring menaxherëve **Editke** dhe **Istvan Kasa**. Edhe ata i plotësojnë me një dinamikë rinor të gjitha sfidat – tashmë prej trembëdhjetë vitesh.

„Jam krenar për linjën tonë sponsorizuese” – thotë Aranka – „**Rex** si Centurio – **Dr. Sandor Milesz** drejtor gjeneral – **Rolf Kipp** diamant i dyfishtë – **Jozsi Szabo** safir – **Miklos Berkics** diamant-safir i cili është sponsori ynë me famë botërore... Linjë e sipërme fantastike, apo jo?!” – dhe qesh!



NË HARMONI

Leksioni familjar i mbajtur në ditën e dytë theksoi detyrat e përbashkëta të sportit dhe MLM-s. Angazhimi, vullneti, këmbëngulja, disiplina, qëllimshmëria, planifikimi, harmonia e motivimit të brendshëm. Në vend të radhitjes, theksi qëndron tek harmonia.

„Rex me FLP-n na dha në dorë një vegël muzikore me ndihmën e të cilës secili mund të gjejë rolin e vet në orkestrën e madhe, dhe me tingujt e tij mund të pasuroj harmoninë e përbashkët!” – u shpreh Andrasi. „Telat akordohen nga dashuria.”

Shtizën e kampionatit botëror të Arankës (shtiza e parë prej alumini në Hungari), të cilën e ruajnë si relike prej tridhjetë vitesh, e morri si stafetë partneri i **Katrinës, Pascali**, që duke e patur parasysh atë të përparoj me sukses në rrugën e menaxhimit. Ai si kuzhinier i njohur francez, u mëson pjesëmarrësve të seminarit të fshehtat e përdorimit të aloe-së FLP-s në kuzhinë. Ëmbëlsirat dhe salcat me aloe korrën sukses të madh, dhe libri i tij u vjen në ndihmë amvisave dhe kuzhinierëve gjithashtu.

Pascal: „Shtiza e dedikuar si simbol i falenderimit që nga ky moment zbukuron murin e shtëpisë sonë!”

Të hënën në mëngjes vizitorët e seminarit dy ditore u kthyen në shtëpi. Mëngjesi i përbashkët me atmosferë të mirë, „mëngjesi i kampionëve”, kurorëzoi ditët me punë të madhe.

„Nga kjo vizitë morra forca, qetësi, përfundim të besimit në të ardhme! Ishte një shpërndarje familjare!” – tha Aranka, e

cila e ftoi Katrinën si mysafire dhe lektore në kursin e saj në Adylyget. Katrin dhe Pascal e pranuan me kënaqësi ftesën.

Kampionët e botës „sinkronizuan orët” – me fjalë të tjera lanë takimet.

Aranka: „E di që 2010 do të jetë viti i skuadrës sime! Do ta vazhdojmë punën me energji, angazhim, vullnet të pafund, qëllime të përfocuara dhe ide të reja. Do kërkoj diamantin tim tjetër!”

Ju uroj suksese të shumta juve, familjes dhe skuadrës suaj në rrugën drejt diamantit!

„Peter, mos harro veten tëndel!” – tha Aranka kur u largua. „Shkruaj edhe që pa ty, si gazetar dhe përkthyes në nivelin e gjuhës nënë, nuk do të dilte kaq mirë ky seminar!”

Rreth vetes sime do të shkruaja vetëm që më kënaq fakti kur u shkruaj miqve të mi rreth NJERËZVE si Aranka, Katrin, András, Pascal dhe Boti. Më mbushin me energji dhe është një nder i madh të bashkëpunosh me ta.

Peter Kószegei
menaxher





Sonya

Konkursi i bukurisë Sonya, Budapest

MË SHUMË SE KONKURS BUKURIE

Njëllor si vitin e kaluar firma jonë shpalli përsëri konkursin e bukurisë Sonya, faza eliminatorë e të cilit në vendin tonë do të mbahet më 26 nëntor.



Si konkuresit, edhe anëtarët e jurisë mbërritën shumë të emocionuar në këtë aktivitet të shkëlqyer, në konkursin e ri Sonya. Gëzohem shumë që ky konkurs ndryshon me të vërtetë nga aktivitetet e tjera të ashtuquajtura “konkurs bukurie”, pasi këtu qëllimi primar është kërkimi i një fytyre të re Sonya e cila me përdorimin e duhur të produkteve tona kozmetike dhe të trajtimit të fytyrës, si dhe të Sonya Color Collection bëhet përfaqësuesja e denjë e kësaj familje produktesh fantastike.

Një nga kriteret ishte edhe niveli i supervizorit, si dhe fakti që personi në fjalë të zotëronte kullë Sonya dhe të mbante rregullisht prezantime kozmetike Sonya. Të tjerët na besojnë me të vërtetë nëse ne vetë bëhemi reklamë e firmës në çdo aspekt.

Pjesëmarrësit duhet të përgatisnin makijazhet për veten e tyre që u përshtateshin veshjeve të biznesit dhe të mbrëmjeve. Juria vlerësoi (ose shvlerësoi!) edhe përdorimin e plotësuesve dhe penelave personal nga pjesëmarrësit.

Pas përgatitjes së makijazhit ditor u bë një prezantim biznesi prej 3-4 minutash me veshjet e duhura për këtë rast (të cilat për fat të keq nuk ishin veshje biznesi për të secilin). Unë mbi të gjitha për këtë isha kureshtare, sepse kur morra pjesë në juri në rallyn europian dhe botëror të vitit të kaluar pashë se kjo ndikon shumë tek rezultati. Pasi ky nuk është një konkurs i zakonshëm, nuk ka vlerë vetëm bukuria e fytyrës dhe cilësia e makijazhit, por janë të rëndësishme edhe edhe përfaqësimi i duhur i produkteve, lojaliteti dhe “dashuria” e ndërë dhe e treguar për Sonyën!

Kjo më mungoi edhe tani tek shumë prezantime. Kurse makijazhet e mbrëmjes ishin shumëherë më të mira – ndoshta edhe falë mbështetjes pozitive të jurisë.

Si përfundim gjetëm dhjetë vajza të cilat me rastin e Success Day-t të dhjetorit të prezantojnë në skenë Sonyën, dhe shpresojmë që me kritikën dhe këshillat tona të marrim një pamje më cilësore rreth produkteve tona me nivel botëror. Falenderojmë gjithë pjesëmarrëset për paraqitjen e tyre dhe u urojmë shumë sukses të kualifikuarave!

Dr. Edit Revesz
kryetare e jurisë





*Nuk ka vlerë vetëm bukuria
e fytyrës dhe cilësia e makijazhit,
por janë të rëndësishme edhe edhe
përfaqësimi i duhur i produkteve,
lojaliteti dhe*

“dashuria”



e ndjerë dhe e treguar për
Sonyën



FOREVER 

IMRPRESSUM

Botues: Forever Living Products Hungari Shpk.

Redaksia: FLP Hungari Shpk. 1067 Budapest, Szondi u. 34. Telefon: (36-1) 269-5373 Fax: (36-1) 312-8455

Kryeredaktor: Dr. Sandor Milesz Redaktor: Valeria Kismarton, Zsuzsanna Petroczy, Kalman Posa, Sandor Rokas, Attila Földi

Layout, përgatitje për shtypje: Crossroad Consulting Shpk.

Koordinator projekti: Szilvia Timar Redaktor leximi: Zita Kempf Korrigjues: Ildiko Kiraly **Redaktor projekti:** Raden Hannawati **Fotograf:** Robert Laszlo Bacsi, Dimitrije Ostojic

Përkthim, redaktim: Dr. Marsel Nallbani (shqip), Darinka Aničić, Žarko Anić Anić (kroat), Otilia Toth-Kasa, Balazs Molnar, Dragana Meseldžija (serb),

Jolanda Novak Csaszar, Biro 2000 Ljubljana (sloven).

Shtypshkronja: Palatia Nyomda és Kiadó Shpk. U përgatit në 39180 kopje.

Për përmbajtjen e artikujve përgjegjësia është e autorëve. Çdo e drejtë mbrohet!

www.flpseu.com

Prijeni dhe silleni me vete!

Kuponi mund të përdoret për konsumim ushqimesh dhe pijesh në restorantin Foleja e Shqiponjave. 1 kupon mund të përdoret vetëm në rastin e konsumimit me vlerë më të madhe se 3000 Ft.

KUPON 1000 FT-SH

RESTORANTI
FOLEJA E SHQIPONJAVE



www.sasfeszeketterem.info

I vlefshëm deri në: 28 shkurt 2010. Budapest, XVIII. ker., Fonal u. 2.



RESTORANTI
FOLEJA E
SHQIPONJAVE



Budapest, XVIII. ker., Fonal u. 2.
www.sasfeszeketterem.info



I PRESIM MYSAFIRËT ME MENU TË RINOVUAR
DHE ÇMIME MË TË FAVORSHME!

USHQIME HUNGAREZE, PICA, LLOJE TË NDRYSHME VERËRASH
RESTORANTI FOLEJA E SHQIPONJAVE

Prijeni dhe silleni me vete!

Kuponi mund të përdoret për marrjen në përdorim të ofertave të Hotelit Kështjella e Szirakit. Për një ofertë mund të përdoret vetëm një kupon dhe nuk mund të kombinohet me ulje të tjera çmimi. Për informacione të mëtejshme interesohuni duke u kontaktuar me ne.

Këto ofertat gjenden në faqen tonë të internetit!

KUPON 10000 FT-SH



web: www.kastelyszirak.info
mail: info@kastelyszirak.info
telefon: 06 32 485 300

I vlefshëm deri në: 28 shkurt 2010



“Elegancë sipas kërkesave aktuale”

Me raste duhet të dalim jashtë ditëve të zakonshme. Të stakojmë telefonin dhe t'i vendosim mënjanë problemet e përditshme. Hoteli Kështjella e Szirakit është vendi më ideal për shplodhje të përsosur.

NA OFRON MË TË MIRËN PREJ GJITHÇKAJE!

Kështjella hotel ju bën qejfin me dhurata me vlerë që ta filloni të mbushur me energji vitin e ri. Zgjidhni mes ofertave tona, prijeni kuponin dhe u bëjmë ulje prej 10000 Ft-sh!

KJO ËSHTË DHURATA JONË E VITIT TË RI PËR JU!

Pije



Forever Freedom2Go™

Shijoni gjithë përparësitë e Forever Freedom® të kombinuar me shëgën me shije ekzotike dhe të pakeluar në mënyrë praktike. Forever Freedom2Go™ përmban karakteristikat e mira të xhelit aloe vera të prodhuar prej nesh, glukozamin, kondroitin, MSM dhe shëgën e ëmbël dhe të pasur në antioksidantë.

Glukozamin-sulfati dhe kondroitin-sulfati janë dy substanca natyrore rreth të cilave kanë përcaktuar se ndihmojnë ruajtjen e strukturës së shëndetshme të kërcit dhe lëvizshmërinë e duhur të kyçeve. Methyl Sulfonyl Methane (MSM) është burimi kryesor i sqfurit biologjikisht të përdorshëm.

Këtyre përbërësve u shtojmë lëngun e shëgës përmbajtja e antioksidantëve të së cilës është më e madhe se sa ajo e verës së kuqe, çajit jeshil apo boronicës.

Merrni qeskën, hapeni dhe shijoni efektet e mira dhe shijen e këndshme të Forever Freedom2Go™!

Vëllimi neto: 88,7 ml

Lëndë ushqyese	100 ml produkt	*RDA %	1 dozë (88,7 ml)	*RDA %
Energji	68Kcal/283 kJ		60 Kcal/251 kJ	
Proteina	<1		<1	
Yndyrë	—		—	
Karbohidrate (g)	15,8		14	
nga këto sheqer(fruktoz)	13,5		12	
Vitamin C (mg)	31,6	39,5%	28	35%
Glukozamin-sulfat-	1238 mg		1125 mg	
Kondroitin sulfat	1014 mg		900 mg	
Metil sulfonil metan	634 mg		562,5 mg	

*RDA % (përqindja e sasisë ditore të rekomanduar të vitaminave në një dozë)

PËRBËRËSIT: xhel AloeVera i stabilizuar (81,39 %), koncentrat lëngu sheqe (10%), fruktoz, glukozamin sulfat, kondroitin sulfat, metil-sulfonil-metan (MSM), aromë sheqe natyrore, acid citrik, lëndë konservuese (sorbat kaliumi, vitamin C (acid askorbik), antioksidant (vitamin E).

Përmban përbërës që rrjedhin nga karkalecat dhe midhjet!

MËNYRA E PËRDORIMIT:

Konsumoni njëherë një ditë gjysmën e njësisë së pakeluar duke e trazuar mundësisht para buke. Sasinë e papërdorur mbajeni në frigorifer dhe duhet ta përdorni brenda 24 orësh me qëllim që të merrni efektin optimal. Mos e konsumoni produktin me paketim të dëmtuar.



- Përmban glukozamin, kondroitin dhe MSM
- Ka shije të shkëlqyer sheqe
- Ka paketim që përdoret lehtë



PRODUCT #306